



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivery	31.05.2021	viti god year	
Organ./Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTK	2757/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.351/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëse, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2338/19 të datës 29.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 30.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër protokoll 2992/2019 të datës 24.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rruga: "Bill Clinton" Dëshmorët e Kombit, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit - Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.424/2019 e datës 24.07.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokoll 145 i datës 11.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratën Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër 02/599/11 të datës 24.11.2016 është i sistemuar në pozitën „Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm” në Departamentin e Funksioneve të Veçanta në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 14.05.2019 përmes shkresës-njoftimit me numër të protokollit 09-06-2068 njoftohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me suprimimin e pozitave të punës si rezultat i riorganizimit të Administratës Tatimore.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 14.05.2019, me datë 12.06.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 11-06-2501 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me pretendim ankimor kundër njoftimit të datës 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të

Kosovës me datë 11.07.2019 merr vendimin me numër të protokollit 145 me të cilin vendim refuzohet si e pa pranueshme ankesa me numër të protokollit 11-06-2501 e datës 12.06.2019 e parashtruar nga ankuesi me arsyetim se ankesa e tij nuk i plotëson kushtet sipas nenit 125 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 11.07.2019 me numër të protokollit 145 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me datë 25.07.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 3292/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa e tij kundër projekt rregullores Nr.ATK-13/2019, ta anulohet si të kundërligjshëm projekt rregullorja Nr. ATK-13/2019 dhe të obligohet autoriteti punëdhënës në ATK për anulimin e të gjithave vendimeve që kanë rrjedh nga projekt rregullorja Nr.ATK-13/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 30.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 08.08.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 06.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2338/19, të pranuar me datë 30.04.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.09.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 25.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2338/19 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar në Këshill me datë 30.04.2021; E-mail i datave 27.08.2019 dhe 30.08.2019; Ankesa e ankuesit e datës 25.07.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 26.04.2019; Ankesa e ankuesit e datës 12.06.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 11.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Procesverbali mbi shqyrtimin e ankesës; Njoftimi i datës 14.05.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Projekt Rregullorja Nr.ATK 13/2019; E-mail i datës 24.06.2016; Struktura e përgjithshme organizative e Administratës Tatimore të Kosovës e datës 10.05.2019; E-mail i datës 16.05.2019; Rregullorja Nr.ATK 13/2019 me numër të protokollit 09-06-2149 të datës 17.05.2019; E-mail i datës 15.05.2019; Vendimi i datës 13.06.2019 me numër 334 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Akt emërimi i datës

24.11.2016; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës dhe pretendimeve ankimore të ankuesit të parashtruar në ankesën e datës 25.07.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës me shkresën e datës 14.05.2019 e ka njoftuar ankuesin dhe nëpunësit tjerë civil për suprimimin e pozitive dhe për procesin e ristrukturimit të Administratës Tatimore të Kosovës, mirëpo nuk e cenuar me këtë shkresë njoftuese të drejtën e ankuesit, dhe ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 paragrafit 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku është përcaktuar se: *“Nëpunësit Civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkëlqe ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”,* sepse ende pa pas një akt administrativ apo vendim që lidhet me vendin e tij të punës ka parashtruar ankesë me datë 12.06.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Po ashtu ankuesi e ka kundërshtuar edhe projekt rregulloren me NR.ATK-13/2019 dhe ka kërkuar nga Këshilli që të anulohet kjo rregullore si e kundërligjshme, Kolegji ka konstatuar se projekt rregullorja nuk ka pasur ndonjë pasojë juridike për ankuesin në raport me të drejtat dhe interesat e tij nga marrëdhënia e punës, respektivisht në këtë fazë të procesit të përgatitjes së Rregullores së kundërshtuar nuk është ndërmarrë ndonjë veprim juridik në dëm të të drejtave të ankuesit që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pa bazuar andaj duke ju referuar edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 44, ku përcaktohet se: *“akt administrativ konsiderohet çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike”, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: “akti administrativ individual”, gjegjësisht “kolektiv”), apo 1.2. i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme (në vijim: “akti administrativ i përgjithshëm”),* si dhe duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, Kolegji vlerëson se Projekt Rregullorja Nr.ATK-13/2019 është akt i karakterit normativ që ka të bëjë me organizimin e brendshëm dhe funksionimin e këtij institucioni dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të natyrës së tillë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për suprimimin e disa pozitive aktuale të punës duke identifikuar staf tepricë, Kolegji bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ka gjetur se organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës përcaktohet varësisht nga fushëveprimi, lloji dhe kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësi të institucionit, me qëllim të ushtrimit të mandatit

ligjor me performancë sa me efikase dhe kosto sa me te vogël, kështu që Kolegji vlerëson se është në diskrecionin të institucionit që të përcaktoj një strukturë funksionale organizative mbi parimet e lartcekura, dhe rrjedhimisht në rast të tepricës së nëpunësve civilë duhet të trajtohen të drejtat dhe detyrat e nëpunësve civilë të cilat përcaktohen nga Qeveria me akte nënligjore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër të protokollit 145 të datës 11.07.2019 ka arritur që ta vërtetoj drejt gjendjen faktike dhe juridike me rastin e vendosjes së ankesës së ankuesit të datës 12.06.2019 sepse ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka atakuar shkresën njoftueses të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës të datës 14.05.2019 lidhur me suprimimin e pozitave të punës si rezultat i riorganizimit të Administratës Tatimore, sepse ankesa e ankuesit nuk i ka plotësuar kushtet e ankesës siç është e përcaktuar me dispozitat e nenit 125 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 145 të datës 11.07.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike për refuzimin e ankesës së ankuesit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.351/2019

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Malsorë GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së